

## KONTRATË

E lidhur me date: 29.11.2019.

**KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**"EBK"-Sh.p.k-Prizren** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Furnizimi me material për rregullimin e ngrohjes qendrore,elektrikes dhe tavanit të kabineteve ne nenkulmin e objektit shkollor' Ilmi Bahtijari" ne fshatin Blaç** me numër Identifikues

**621-19-8650-1-3-6, dhe nr. te brendshem 621-2019-145-136**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizimi me material për rregullimin e ngrohjes qendrore,elektrikes dhe tavanit të kabineteve ne nenkulmin e objektit shkollor' Ilmi Bahtijari" ne fshatin Blaç**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **29.11.2019, dhe përfundon me date 20.12.2019**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes së furnizimeve] do të jetë **Shkolla fillore ne Blaç**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.6. Menagjer i kontrates **Naser Meleqi**

1.6. Menagjer i projektit(furnizimit) **Xhevat Isufi**

**1.7 Menagjeri i Operatorit Ekonomik: Bekim Muja**

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA E KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragas  
03 Nr. Br. 400-28784  
29-11 20 19  
Dragas - Dragas

REPUBLICA E KOSOVES

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **3,746.00 €; ( tre mij e shtateqind e dyzet e gjashte Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

*Ne fund kerkohet nje raport per pranim te mallit nga ana e menagjerit te kontrates dhe komisionit per pranim te mallit.*

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *[furnizimeve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit *[furnizimeve]*,

### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.



## Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykatën themelore në Prizren, dega në Dragash** në pajtim me ligjin e Kosovës.

## Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E KCL  
DRA  
KOM.  
OPB  
DRJ  
VAC

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] <sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.


Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

<b>Emri:</b>	<b>“EBK”-Sh.p.k-Prizren</b>	<b>Emri:</b>	Nuro Ismaili <i>145</i>
<b>Pozita:</b>	<i>DRE</i>	<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	29.11.2019.	<b>Data:</b>	29.11.2019.
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



**1. PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE-ARKITEKTURA****Paramasa dhe paralogaria**

**Furnizimi me material per rregullimin e ngrohjes qendrore, elektrikes dhe tavanit te kabineteve në nënkulmin e objektit shkollor SHFMU "Ilmi Bahtijari " në Blaç**

Në çmim njësi duhet të parashihet blerja, furnizimi, punimi/montimi i çdo materiali me pozicionim sipas paramases dhe testimi i materialeve para lëshuarjes ne pune. Sistemimi i materialeve, pastrimi i punishtes nga mbeturinat gjatë dhe pas kryerjes se punimeve. Për te gjitha materialet dhe produkte ndërtimore qe përdoren, paraprakisht te ofrohen certifikatat mbi kualitetin e tyre te cekura edhe ne pozicion. Materialet dhe produkte ndërtimore se dhënë ne pozicion nuk duhet te ndryshohen apo zëvendësohen pa aprovim nga organi mbikqyres.

Në çmim njësi duhet të parashihet qe hjekja, demolimi dhe bartja bëhet me dorë deri te makina e transportit. I gjithë materiali bartet me mjete te transprtit deri në deponinë e caktuar .

1	PUNËT E DEMOLIMIT	Njesia	Sasia	€/Njësi	€/Total
1.1	Furnizimi, transportimi dhe montimi i skeleve per punimin e plakës se kulmit me plakë gipsi në lartësi 4.5m. Skelet duhet te llogariten ne m2 te siperfaqes se mbuluar ne kohëzgjatje nga fillimi deri ne perfundim te planit dinamik te ofruar.	m <sup>2</sup>	75	0.10 €	7.50 €
1.2	Hapja e vrimave te pllakes ekzistuese nga betoni i armuar per lidhjen egzistuese te gypave te nxemjes ne mes te katit dhe largimi i materialit deri ne deponin e avtetit	m <sup>2</sup>	45.00	6.50	292.50 €
<b>Total pos. 1</b>					<b>300.00 €</b>

2	PUNËT E BETONIT DHE LATIMIT	Njesia	Sasia	€/Njësi	€/Total
Punëmarrësi duhet te kete parasysh qe duhet te furnizohet me material kualitativ me te gjitha standardet ne fuqi ku para perdorimit te cdo materiali duhet te prezentoj organit mbikqyres te gjitha atestet e nevojshme per pranim dhe perdorim te materialeve.					
2.1	Furnizimi me beton te armuar C-25/30 dhe punimi i serklazhit mbi derë dhe shtangimit te murit te ri (serklazhit horizontal me dimensione (25x25x160)cm. dhe mbyllja e vrimave ne pllaken e meskatit ( me pare te hapura per gypa te radiatorit). Ne çmim të përfshihen edhe latimi, vibërimi, rrafshimi dhe demontimi i pahive.	m <sup>3</sup>	1.00	60.00	60.00 €
<b>Total pos. 2</b>					<b>60.00 €</b>

3	PUNËT E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES	Njesia	Sasia	€/Njësi	€/Total
3.1	Furnizimi dhe punimi i tavaneve te varura me plake gipsi t=12,5mm Montimi me konstrukcion metalik te varur te dyfishte si profil mbajtes dhe montues i fiksuar me varese. Siperfaqja e fiksimit ne trajet nga druri, distanca e leshimit sipas kerkeses se mbikqyresit. Ne çmim te llogariten edhe mbushjet e fugave sipas detajeve te prodhuesit dhe rajtimi final i siperfaqeve ne kualitetin K3, me paralyerje (prajmer Knauf Spezial Grund). Llogaritja ne meter katror te punuar.	m <sup>2</sup>	74.00	16.00	1,184.00 €



3.2	Furnizimi me materialit dhe patinimi (gletimi) i plafonit ne dy shtresa deri ne pregaditjen e siperfaqes per pranimin e ngjyres.	m <sup>2</sup>	74.00	2.00	148.00 €	✓
3.3	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe tavanit te brendshme me baze dhe ngjyre ekologjike. Ngjyra duhet te jete per ambiente te brendshem ekologjike, e cila hullohet me uje 10%, rezistente ne ferkim te thate. Ngjyrosje behet ne dy shtresa, ngjyra caktohet nga projektuesi /mbikeqyresi. Llogaritet ne meter katror te siperfaqes se mbetur.	m <sup>2</sup>	74.00	1.00	74.00 €	✓
<b>Total poz. 3</b>					<b>1,406.00 €</b>	✓

4	PUNËT E ELEKTRIKËS	Njesia	Sasia	€/Njësi	€/Total	
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupave ndriçues LED 24W, me dimensione: rrethor me diameter 265mm, 200K, 1850 lm, apo me karakteristika teknike te ngjashme.	copë	80	4.00 €	320.00 €	✓
<b>Total poz. 4</b>					<b>320.00 €</b>	✓

5	PUNËT E MAKINERISË	Njesia	Sasia	€/Njësi	€/Total	
5.1	Kolektorët për shpërndarje dhe mbledhje komplet me valvolat dhe xhunot (lidhset) një pjesëshe R -15, valvolat automatike për ajrosje dhe valvolat e zbrazjes të montuara në kolektorët e shpërndarjes dhe mbledhjes R -15					
5.2	Ø 1" / 5x1/2"	copë	4	40.00 €	160.00 €	✓
5.3	Ø 1" / 2x1/2"	copë	4	25.00 €	100.00 €	✓
5.4	Valvola sferike (flutur) për lidhjen e gypit ne kolektorët DN - 25	copë	4	30.00 €	120.00 €	✓
5.5	Gyp çeliku DN 32	m	90	4.00 €	360.00 €	✓
5.6	Pastrimi dhe lyerja e gypave dy herë me minimum e gypave	cca	1	30.00 €	30.00 €	✓
5.7	Lyerja e gypave me ngjyrë të yndyrshme dhe të rezistueshme në temperaturë	cca	1	30.00 €	30.00 €	✓
5.8	Material tjetër i nevojshëm për kompletimin e rrjetit gypor të shpërndarjes	Komplet	1	100.00 €	100.00 €	✓
	Radiator panell të çelikut tip: 22/600 prodhim nga fabrika e radiatorëve "ENRAD" Gjilan, apo të prodhuesve tjerë me dimensione si vijon:					
5.90	22-400 x 2000	copë	2	150.00 €	300.00 €	✓
5.10	22-600 x 1600	copë	3	120.00 €	360.00 €	✓
5.11	Ventil për radiator të sistemit dy-gypor me termokokë	copë	5	10.00 €	50.00 €	✓
5.12	Ventil për radiator të sistemit dy-gypor dalje	copë	5	10.00 €	50.00 €	✓
<b>Total poz. 5</b>					<b>1,660.00 €</b>	✓

REKAPITULIMI I PUNEVE NDERTIMORE DHE ZEJTARE		
1	PUNËT E DEMOLIMIT	
2	PUNËT E BETONIT DHE LATIMIT	300.00
3	PUNËT E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES	60.00
4	PUNËT E ELEKTRIKËS	1,406.00
5	PUNËT E MAKINERISË	320.00
<b>TOTALI I PUNEVE NDERTIMORE DHE ZEJTARE :</b>		<b>3,746.00 €</b>

